



Plannat / Dorezuar Puniljeno/Prodato Received/Delivry	05.08.2022	viti god year	
Organ /Njesia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SRON/PHU	4552/2022		1/4



Republika e Kosovës  
Republika Kosova -- Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.566/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Jeton Koca-anëtarë, si dhe Flakron Gashi- Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr. 566/2022 të datës 24.06.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë: Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datë 05.08.2022, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

HEDHET poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.566/2022 e datës 24.06.2022 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi nëpunës civil në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, më datë 24.06.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 3695/2022 nën shenjën A.nr. 566/2022, kundër Vendimit me numër protokolli SP-02/2959/2022 të datës 24.05.2022 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës, me pretendimet ankimore se ky vendim përbën shkelje të dispozitave të procedurës administrative dhe të dispozitave të ligjit material që garantojnë të drejtat që burojnë nga marrëdhënia e tij e punës referuar aktit të emërimit i nënshkruar me datë 26.12.2014.

Po ashtu, ankuesi me datë 01.08.2022 ka bërë plotësimin e ankesës me nr. Protok3695/2022 të datës 24.06.2022 në kuptim të precizimit të aktit administrativ të atakuar, ndërsa qëndron pranë pretendimeve ankimore sikurse në ankesë, ndërsa tani e kundërshton Vendimin e datës 29.07.2022 me numër protokolli:2959-2/22 të nxjerrë nga Sekretari i Përgjithshëm i MAPHI përmes të cilit është shfuqizuar Vendimin nr. SP-02/2959/2022 të datës 24.05.2022 dhe këtë veprim Sekretari i Përgjithshëm i MAPHI e mbështet në Vendimin Nr. 4226/22 të datës 27.07.2022 të Ministrit të

Ministrisë së Ambientit Planifikimit Hapësinor dhe të Infrastrukturës përmes të cilit ka bërë bashkimin e Divizioneve të Prokurimit Publik sikurse bashkimi ministrive respektive.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 29.06.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ndërsa kjo e fundit më datë 05.07.2022 ka dërguar vetëm shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën e ankuesit e datës 24.06.2022 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin e datës 24.05.2022 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit, Hapësinor dhe Infrastrukturës; e-mail i datës 02.06.2022; Akt emërimi i ankuesit i datës 26.12.2014; Përshkrimi i detyrave të vendit të punës si dhe përgjigja në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Shkresën për plotësimin e ankesës e datës 01.08.2022; Vendimin e datës 29.07.2022 me numër protokoli:2959-2/22 të nxjerrë nga Sekretari i Përgjithshëm i MAPHI; E-mailin e datës 02.06.2022 dërguar nga \_\_\_\_\_ për \_\_\_\_\_ me korrespondencën e bashkangjitur të e-maileve zyrtare në përbërje prej dy (2) faqesh.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar provat materiale lidhur me këtë çështje juridike, kontestoi se ankesa e ankuesit \_\_\_\_\_ është e pa lejueshme, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, nga administrimi i shkresave të lëndës ka gjetur se ankuesi sipas Aktit të Emërimit të nënshkruar të datës 26.12.2014 është emëruar Drejtor i Prokurimit në Ministrinë e Infrastrukturës. Më tej, nga provat e lëndës rezulton se me Vendimin me numër protokoli Nr.2959/2022 të datës 24.05.2022 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, \_\_\_\_\_ caktohet zyrtar përgjegjës për menaxhimin e Divizionit të Prokurimit në kuadër të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ndërsa me datë 29.07.2022 Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm ka shfuqizuar Vendimin Nr.2959/22 të datës 24.05.2022 pasi që Ministri i Ministrisë së Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës ka marr Vendim me Nr.4226/22 me të cilin ka bërë bashkimin e dy Divizioneve me arsyetimin se ky vendim nxirret më qëllim të koordinimit të aktiviteteve të dy Divizioneve të Prokurimit dhe rrjedhimisht si i tillë do të jetë i zbatueshëm deri në hyrjen në fuqi të Rregullores për Organizimin e Brendshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Ankuesi në ankesën e tij të ushtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës sikurse edhe në plotësimin e ankesës së datës 01.08.2022 në kuptim të precizimit të aktit të atakuar, pretendon së me Vendimin me numër numër:73/2022 të datës 29.07.2022 përmes të cilit është shfuqizuar Vendimi me numër protokoli 2959/2022 i datës 24.05.2022, janë shkelur dispozitat procedurale dhe materiale ligjore, duke vendosur në mënyrë të gabuar dhe jo të drejtë lidhur me çështjen administrative dhe se i njëjti përbën shkelje të ligjeve në fuqi të Ligjit për Zyrtarët Publikë, Rregullores Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë si dhe ligjeve tjera relevante.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ngritura në ankesë, Kolegji ju referua dispozitave të nenit 10 paragrafi 2 dhe 3 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, më të cilin është përcaktuar se: *...2.Ministri (në vijim: ministri përgjegjës) drejton dhe kontrollon veprimtarinë e sistemit ministror dhe mbikëqyr veprimtarinë e agjencive në fushën përkatëse të përgjegjësisë shtetërore, në pajtim me këtë ligj. 3. Funksonimi i sistemit të përgjegjësisë të ministrit për performancën e sistemit ministror përcaktohet në pajtim me legjislacionin për funksionimin e Qeverisë, ndërlidhur me këtë Rregullorja (QRK)-Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive përkatësisht neni 8 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 ka paraparë se : "1. Ministri, në pajtim me Kushtetutën, legjislacionin në fuqi, politikat dhe udhëzimet e përcaktuara nga Qeveria apo Kryeministri:...1.5 Kryen detyra të tjera në kuadër të fushës së përgjegjësisë administrative të ministrisë, të përcaktuara me legjislacionin në fuqi"... rrjedhimisht bazuar në këto dispozita ligjore dhe meqenëse Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës ende nuk e ka të përfunduar procesin e ristrukturimit pas bashkimit të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Ministrisë së Infrastrukturës, atëherë sipas vlerësimit të Kolegjit vendimi i kundërshtuar me ankesa është nxjerrë në funksion të koordinimit të aktiviteteve të Divizionit të Prokurimit pranë kësaj ministrie dhe së i tillë ky vendim ka efekt juridik të përkohshëm gjegjësisht deri në miratimin e Rregullores për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin Vendeve të Punës në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës respektivisht ky vendim nuk ka të bëjë me procesin e sistemit të stafit në rast të riorganizimit lidhur me të cilin proces zbatohet rregullimi ligjor sipas dispozitave të nenit 54 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.*

Andaj, meqenëse vendimet e Ministrit të Ministrisë së Ambientit, Planifikimit Hapësinor dhe të Infrastrukturës si dhe Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të kësaj Ministrie kanë karakter të përkohshëm deri në nxjerrjen e Rregullores së brendshme për organizim dhe ristrukturim të MAPHI, Kolegji konstaton se nuk ka cenim të drejtave nga marrëdhënia e punës, pasi që edhe në bazë të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës në nenin 23 paragrafi 1 përcaktohet se: *"ZKA i autoritetit kontraktues përcakto një person të shërbej si zyrtar Përgjegjës i Prokurimit për autoritetin kontraktues...."*.

Kolegji i Këshillit në vështrim të dispozitave të nenit 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë konstaton se çdo nëpunës civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e punës. Andaj, në këtë kuptim si dhe referuar nenit 124 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *"Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim..."*, Kolegji i Këshillit vlerëson se me Vendimin me numër numër:73/2022 të datës 29.07.2022 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës, nuk është cenuar ndonjë e drejtë apo interes juridik i ankuesit i cili është i përcaktuar në mënyrë specifike lidhur me marrëdhënien e tij të punës e përcaktuar sipas Aktit të Emërimit të nënshkruar të datës 26.12.2014, andaj bazuar në këtë konstatim, Kolegji vlerëson se ankesa e parashtruar nga ankuesi e precizuar dhe plotësuar edhe përmes shkresës së datës 01.08.2022 është e paqëndrueshme dhe si e tillë hedhet poshtë si në dispozitiv të këtij vendimi, pasi që pozita dhe të drejtat që burojnë nga akti i përhershëm i themelimit të marrëdhënies së punës gjegjësisht paga nuk i janë cenuar me aktin e kontestuar, pasi që i njëjti siç e kemi pasqyruar edhe në arsyetimin e këtij



vendimi ka karakter të përkohshëm, rrjedhimisht si i tillë do të jetë i zbatueshëm deri në hyrjen në fuqi të Rregullores për Organizimin e Brendshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Siç u tha me sipër, Kolegji i Këshillit pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.566/2022

**Flakron GASHI**

Procesmbajtës

**Malsore GASHI BAJRAKTARI**

Kryetare e Kolegjit

**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankuesit
- Ministrit të Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës;
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së,